




Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
ORGANIZIMET E PROKURIMIT
TELEKOMUNIKACIONE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbledhja e Eks. Shqyrtues dhe Mbledhja e	Data e dorëzimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:
Hasim Krasniqi	03.06.2020	10.06.2020	332/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.05.2020, grupi i OE "Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr. 332/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE "Krojer e Nazeri Sh.p.k"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi i objekteve të Komandës së Prishtinës" me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 2.100.000,00 €.

Ankesa është e përsëritur, ky aktivitet është trajtuar me Vendimin e OSHP-së, PSH nr.735-744-757/19 dt.09.12.2019 dhe Vendimin e OSHP-së, PSH nr. 82,83,90/2020 dt.11.03.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE Ankesa 332/20

Dispozitat e shkelura sipas, grupit te OE "Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove"- Prishtinë, te cilet kanë parashtruar ankesë me nr: 332/20, janë:

- Neni 1 - Qëllimi
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 59 -Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 -Kriteret për dhënien e kontratës
- Neni 61 -Tenderët jo-normalisht të ulët
- Neni 72 -Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik
- Rregullat per tenderet Neni 3 neni 4

pikat e ankesës:

Te Nderuar

Edhe pse disa here ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim gjatë kësaj procedure, duke paraqitur, të gjitha provat tona dhe duke dokumentuar të gjitha pretendimet tona AK ka anashkalluar dhe nuk ka marrë parasysh asnjëherë kërkesën tonë për rishqyrtim.

Ne jemi detyruar që dy herë deri më tani të paraqesim ankesë edhe pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe po i njëjti institucion ka sygjerruar që AK të respektoj nenin 60 të LPP-së, i cili në asnjë rast nuk është



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:
Hasim Krasniqi	03.06.2020	10.06.2020	332/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **27.05.2020**, grupi i OE “Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **332/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Rojet e Nderit Sh.p.k”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit: **616-19-3238-2-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prishtinë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **2.100.000,00 €**.

Ankesa është e përsëritur, ky aktivitet është trajtuar me Vendimin e OSHP-së, PSH nr.735-744-757/19 dt.09.12.2019 dhe Vendimin e OSHP-së, PSH nr. 82,83,90/2020 dt.11.03.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE Ankesa 332/20

Dispozitat e shkelura sipas, grupit te OE “Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove”- Prishtinë, te cilet kanë parashtruar ankesë me nr: **332/20**, janë:

- Neni 1 - Qëllimi
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 59 -Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 -Kriteret për dhënien e kontratës
- Neni 61 -Tenderët jo-normalisht të ulët
- Neni 72 -Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik
- Rregullat per tenderet Neni 3 neni 4

pikat e ankesës:

Te Nderuar

Edhe pse disa here ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim gjatë kësaj procedure, duke paraqitur, të gjitha provat tona dhe duke dokumentuar të gjitha pretendimet tona AK ka anashkaluar dhe nuk ka marrë parasysh asnjëherë kërkesën tonë për rishqyrtim.

Ne jemi detyruar që dy herë deri më tani të paraqesim ankesë edhe pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe po I njejt i institucion ka sygjerruar që AK të respektoj nenin 60 të LPP-së, i cili në asnjë rast nuk është

repsektuar duke bërë shkelje dhe mospërfillje të vendimeve të OSHP me nr.82,83,90/2020 dhe nr.735,734,757, për të vazhdua duke mos përfillur poashtu edhe mendimin e ekspertit shqyrtues për dy herë radhazi.

AK ka shpallur fitues konsorciumin "Commando" "Aulona POI" dhe "GFS" edhe përkundër se ky grup OE kishte mangësi në dokumentacion dhe ishte I papërgjegjeshëm, e poashtu tash së fundi ka shpallur si fituese kompanine "Rojet e Nderit" sh.p.k, e cila kompani ka tejkaluar në masë të madhe buxhetin e paraparë të AK, shkelje kjo e cila dëmton dhe paraqet paraprakisht keqpërdorim të parasë publike nga AK, përkatësisht zyra e prokurimit, duke I dhënë një tender gjithsej 728.006.40 euro më të shtrenjtë se tenderi I konsorciumit tonë.

Me dt.19.05.2020 kemi marrë vendimin nga AK në të cilin thuhet se Komuna e Prishtinës shpërblen Rojet e Nderit me cmime me te lire te pergjegjeshem"

Derisa tenderi I grupit të OE U.I.S.A" sh.p.k dhe "NAZERI 2000" SH.P.K. dega në Kosovë, është refuzuar me arsyetimin si tender jo normalisht I ulët

Ne kemi bërë për dy here kërkesa dhe ankesa për rishqyrtim pranë AK e poashtu edhe pranë OSHP, mirëpo AK nuk ka përfillur këto kërkesa dhe ne detyrohemi që prapë ti drejtohem OSHP me ankesë për të tretën herë duke argumentuar dhe treguar se AK është duke bërë shkelje të njëpasnjëshme të LPP-së përkatësisht neneve:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 60 Kriteret per Dhënien e Kontratës

Neni 61 Tenderëtjo-normalisht të ulët

Neni 72 Rregullat për tenderëtjo normalisht të ulët dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik

Rregullat për tenderët

Neni 3 neni 4

Në lidhje me pretendimet tona ankimore për të mos ngarkuar këtë ankesë me material I cili tashmë është dorëzuar disa herë të AK si dhe te OSHP, ju lutem referojuni materialit të bashkëngjitur me ankesën, ku do të gjeni kërkesat për rishqyrtim, ankesat në OSHP dhe dëshmitë që tregojnë qartë pretendimet tona ankimore deri më tani në këtë AP.

Kërkojmë nga OSHP që të trajtojë këtë lëndë në mënyrë të barabartë për të gjithë O I E pjesëmarrës në këtë AP, dhe të jepë edhe njëherë sugjerimin e tij si organ më i lartë i prokurimit public në Republikën e Kosovës, lënda të kthehet në rivlersim dhe të repsektohet neni 60 kriteri për dhënien e kontratës, kriter ky I cili ka qenë tenderi I përgjegjshëm me cmimin më të ulët.

Dëmet materiale

Mundësinë e shpërblimit me kontratë.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta me pretendimet e parashtruara nga OE me kërkesen për rishqyrtim në AK.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Kriteret e Dhënies

Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

1. **“Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove”- Prishtinë:** Bazuar në kërkesat e FDT-së dhe ligjin e punës rrjedh se çmimi juaj 2,379,456.00 € është çmim jonormalisht i ulët.
2. **“K.S.Besa Security Sh.p.k.”- Prishtinë:** Bazuar në kërkesat e FDT-së dhe ligjin e punës rrjedh se çmimi juaj 2,561,414.40 € është çmim jonormalisht i ulët.
3. **“COMMANDO Sh.p.k. & Group For Security Sh.p.k. & “AULONA-POL-1 Sh.p.k”-Prizren:** Me vendimin e OSHP-së të dt.11.03.2020 ju nuk përmbushni kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, nuk arrini vlerën minimale prej 3,000,000.00 Euro, në (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Andaj për këtë aktivitet jeni i papergjegjshëm.

Komisioni i vlerësimit ka rekomanduar ZP që me kontratë të shpërblehet grupi i OE “Rojet e Nderit Sh.p.k”- Prishtinë, me çmim me te lirë në vlerë prej: 3,107,462.40 euro.

Menaxheri i prokurimit, ka aprovuar rekomandimin e komisionit të vlerësimit.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Qasja ne dokumentacionet te cilat gjenden në platformën e e-prokurimit që janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitura nga operatorët ekonomik pjesmarres në këtë aktivitet të prokurimit.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

Duke u bazuar në shkresat e lëndes, mendoj se operatori ekonomik ankues nuk është palë interesi në këtë aktivitet të prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimin e OSHP-së, PSH nr.735-744-757/19 dt.09.12.2019 dhe Vendimin e OSHP-së, PSH nr. 82, 83, 90 /2020 dt.11.03.2020.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove”- PRISHTINË-Ankesa 332/20

Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes së tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 10, 52, 59, 61 dhe 72 të LPP-së si dhe nenet 3 dhe 4 të Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët, me rastin e refuzimit të tenderin tone, me arsyetimin se:

"Ne jemi detyruar që dy herë deri më tani të paraqesim ankese edhe pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe po I njejt i institucion ka sygjerruar që AK të respektoj nenin 60 të LPP-së, i cili në asnjë rast nuk është respektuar duke bërë shkelje dhe mos përfillje të vendimeve të OSHP me nr.82,83,90/2020 dhe nr.735,734,757, për të vazhdua duke mos përfillur poashtu edhe mendimin e ekspertit shqyrtues për dy herë radhazi.

AK ka shpallur fitues konsorciumin "Commando" "Aulona POI" dhe "GFS" edhe përkundër se ky grup OE kishte mangësi në dokumentacion dhe ishte I papërgjegjshëm, e poashtu tash së fundi ka shpallur si fituese kompanine "Rojet e Nderit" sh.p.k, e cila kompani ka tejkaluar në masë të madhe buxhetin e paraparë të AK, shkelje kjo e cila dëmton dhe paraqet paraprakisht keqpërdorim të parashë publike nga AK. përkatësisht zyra e prokurimit, duke I dhënë një tender gjithsej 728,006.40 euro më të shtrenjtë se tenderi I konsorciumit tonë.

Me dt.19.05.2020 kemi marrë vendimin nga AK në të cilin thuhet se Komuna e Prishtinës shpërblen Rojet e Nderit me cmime me te lire te pergjegjshem"

Derisa tenderi i grupit të OE "I.S.A" sh.p.k dhe "NAZERI 2000" SH.P.K dega në Kosovë, është refuzuar me arsyetimin si tender jo normalisht i ulët ",

duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara sepse AK me rastin e rivlerësimit të ofertave nuk i ka zbatuar në tërësi Vendimin e OSHP-së, PSH nr.735-744-757/19 dt.09.12.2019 dhe Vendimin e OSHP-së, PSH nr. 82, 83, 90 /2020 dt.11.03.2020 duke mos marr parasysh rekomandimet e dalura nga këto vendime që AK me rastin e rivlerësimit të ofertave të merr parasysh qëllimin, menyrën më efikase dhe më transparente qysh parashihet me ligjin për prokurim publik si dhe kërkesat e parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nga vetë AK.

Po ashtu eksperti shqyrtues, duke pas parasysh arsyjen e eliminimit të AK-së për grupin e OE ankuese "Bazuar në kërkesat e FDT-së dhe ligjin e punës trijedi se çmimi iuaj 2,379,456.00 € është çmim jonormalisht i ulët", konstaton se nese merren parasysh vlerat e ofertave financiare të operatorve ekonomik të cilet sipas AK janë të përgjegjshëm administrativisht dhe trajtohen konform nenit 3 dhe 4 të "Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët" atëher grupi i OE ankues por edhe asnjëri nga operatorët ekonomik pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk i plotësojnë kushtet e parapara për tu trajtuar si operator

ekonomik që përmbajn ofertë financiare Jo-normalisht të ulët.

Si dhe hartimi i dosjes se tenderit nga ana e AK-së, respektivisht hartimi i tabelës së përshkrimit të çmimit duke përshkruar vetëm numrin e pozitave dhe orëve pa specifikuar numrin minimal të punëtorve që duhet të angazhojnë operatorët ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit, ka lënë hapësirë që operatorët ekonomik të paraqesin ofertën financiare duke planifikuar numrin e punëtorve sipas dëshirës së vetë respektivisht aq sa kanë menduar vetë që është e nevojshme të angazhojnë, dhe ky fakt po ashtu paraqet problem për të konstatuar se cila nga ofertat nuk mund ti përmbahen dispozitave të parapara me ligjin e punës.

Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka planifikuar buxhet të rrafshueshëm për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse me rastin e inicimit të procedurës në “Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimin e disponueshmërisë së fondeve” është paraqitur buxheti në vlerë prej 2,100,000.00 € (nga 700,000.00 € për secilin vitë 2019, 2020 dhe 2021) ndërsa në faqen 3 të kësaj deklarate në pjesën ku parashihet nënshkrimi i kësaj deklarate nga zyrtari i prokurimit, zyrtari kryesor financiar dhe zyrtari kryesor administrative me qëllim që të konfirmohet edhe njëherë buxheti para se të shpallet vendimi i AK është dhënë deklarata se pajtohen që të shtohet buxheti prej 140,000.00 € për vitin 2019 dhe nga 80,000.00 € për dy vitet tjera, e që nënkupton se aprovimi buxhetor shtesë për këtë aktivitet të prokurimit e rritë buxhetin e planifikuar në vlerë totale prej 2,400,000.00 €, me qka nënkuptohet se AK ka rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik “Rojet e Nderit Sh.p.k”- Prishtinë, në vlerë financiare prej: 3,107,462.40 euro, e cila vlerë e tejkalon buxhetin e planifikuar për 707,462.40 €, nga kjo rrjedh se AK qysh para hyrjes në marrëdhënie kontraktuale me Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë, me ofertën dhe çmimet e ofertuara nga ky OE, kanë informacion se do të tejkalohet pragu apo tavani siç parashihet me nenin 38 të LPP-së.

Bazuar në këto fakte eksperti mendon se AK me rastin e vlerësimit nuk ka vepruar konform paragrafit 3 të nenit 52 të LPP-së, ku thuhet “*Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kriteret e tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencë teknike.*”

Po ashtu është vepruar në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së ku thuhet “*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*”

Gjithashtu eksperti shqyrtues konstaton se oferta e operatorit ekonomik ankues është më e lirë në vlerë prej 728,006.40 € se sa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e grupit të OE ankues të aprovet si **pjesërisht e bazuara**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe duke pas parasysh se shkeljet e hasura në këtë aktivitet të prokurimit nuk mund të korigjohen në këtë fazë si dhe më qëllim të trajtimit të barabart të të gjithë operatorve ekonomik pjesmarres në këtë aktivitet të prokurimit, rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të **Anullohet**, me qëllim që autoriteti kontraktues me rastin e ritenderimit të hartoj kërkesat dhe kritere të matshme në përputhje me aktivitetin e prokurimit si dhe duke respektuar në tërësi ligjin dhe rregullat detyesore për prokurim publik.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|--|
| - Autoritetit Kontraktues | - Kuvendi Komunal-Prishtinë. |
| - Panelit Shqyrtues | - OSHP. |
| - OE ankues | - "Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove"- Prishtinë. |